



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1008/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS NË PRISHTINË - Dhomat e shkallës së dytë, nga gjyqtari individual Ramush Bardiqi, në çështjen përbarimore të kreditorit KSF Rojet e Nderit Shpk NB ... me selie ne Prishtinë, ndaj debitorit Komuna e Prishtinës, me bazë juridike përbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitori, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkalles e pare-Departamenti për Çështje Ekonomik, KPPP.nr.639/22, të datës 30.05.2023, me datë 20.11.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e Komunës se Prishtinës, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkalles e pare-Departamenti për Çështje Ekonomik, KPPP.nr.639/22, të datës 30.05.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkalles e pare-Departamenti për Çështje Ekonomik, me aktvendimin e nakimuar e ka refuzuar prapësimin e debitorit, i paraqitur kundër urdhrit për lejimin e përbarimit P.nr.635/21 dt.13.04.2021, dhe atë ne vlerën e borxhit ne shumën 19488.68€, ndërsa ka mbet ne fuqi Urdhri përbarimor P.nr.635/21 dt.13.04.2021.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori për shkak te vërtetimit të gabuar dhe jo te plote të gjendjes faktike, me propozim qe gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj këtë ankesë, aktvendimin e ankimuar te prishë dhe lenden te kthej në rishqyrtim dhe rivendosje.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori ka paraqitur propozim për përmbarrim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm-faturës te pranuar nga debitori. Përmbarruesi Privat, me urdhrin përmbarrimor P.nr.635/21 dt.13.04.2021, ka lejuar përmbarrimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit borxhit prej 19488.68€, se bashku me kamatën 8% nga datës se arritjes se pagesës se faturës e deri ne pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës.

Kundër urdhrin përmbarrimore, debitori ka ushtruar prapësim, me propozim qe gjykata ta aprovoj ne tërësi këtë prapësim dhe urdhrin përmbarrimor të shfuqizohet.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkalles se pare-Departamenti Ekonomik, me aktvendimin e ankimuar, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, i paraqitur kundër urdhrin për lejimin e përmbarrimit, të Përmbarruesit Privat, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar së përmbarrimi është lejuar në baze te dokumentit të besueshëm dhe rrjedhimisht te njëjtat paraqesin baze për lejimin e përmbarrimit ne kuptim nga neni 29 LPP. Andaj marrë parasysh këto gjykata e shkallës e pare ka vendosë si ne dispozitiv te aktvendimit.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale-Dhomat e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarrimore kur ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin të përmbarruesit privat, me të cilin është caktuar përmbarrimi i propozuar nga kreditori, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarrimi është lejuar në bazë të faturave të lëshuara nga kreditori, te cila fatura në mbështetje të nenit 29 paragrafi 1 pika 1.3 të LPP-së, kanë cilësinë e dokumentit të besueshëm dhe te njëjtat si te tilla paraqesin bazë juridike për caktimin e përmbarrimit, ashtu siç përcaktohet me dispozitën e nenit 21 të njëjtit ligj. Propozimi për përmbarrim i ushtruar nga kreditori, po ashtu rezulton të jetë ne pajtim me nenin 37 të LPP-së e cila thotë se *“kur propozimi për përmbarrim paraqitet ne bazë te dokumentit te besueshëm, mjafton qe propozimit ti bashkëngjitet dokumentit tillë ne origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”* çka edhe gjykata shkalles e dytë vlerëson se kreditori ka vepruar ne pajtim me këtë nen, nga te cilat fatura te besueshme është caktuar përmbarrimi.

Në rastin konkret Gjykata e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e shkalles se dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK dhe as ne konstatim te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Po ashtu vlerëson se në bazë të dokumentit të besueshëm-faturën, të cilat kreditori ia ka bashkangjitur me rastin e ushtrimit të propozimit për përmbarim, janë plotësuar kushtet ligjore për caktimin e përmbarimit të propozuar nga kreditori, ngase faturat e lartcekura, në bazë të së cilave është caktuar përmbarimi, ligjërisht paraqesin bazë juridike për caktimin e përmbarimit sepse të njëjtat janë pranuar dhe vulosur nga debitori, prandaj gjykatë vlerëson se debitori në rastin konkret nuk ka ofruar prova juridikisht të vlefshme në mbështetje të pretendimeve të tij konform nenit 69 par.5 të LPP, me çka nuk janë plotësuar as kushtet ligjore nga neni 71 të LPP, prandaj vendosi që këto pretendime të refuzoj si të pabazuara.

Andaj në baze të dispozitave ligjore të lartcekur dhe shkresave të lenden rezultojnë se urdhërim përmbarimor i plotësuar kushtet ligjor të LPP. Ndërsa lidhur me pretendimin tjetër gjykata vlerëson se pretendimet e debitorit rezultojnë të jenë të pabazuara dhe të paargumentuara ashtu që si të tilla mbesin vetëm në natyrën deklarative dhe jo relevante për të vendosur ndryshe, nga del se nuk plotësohen as kushtet ligjore nga neni 71 i LPP.

Përndryshe, në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkalles së Dytë
K.DH.SH.II nr.1008/23, me datë 20.11.2023

Gjyqtari,
Ramush Bardiqi